



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr 3247 prot.

Datë 24/11 /2022

VENDIM

Nr. 34, datë 23.11.2022

**“Për tarifën e shkollimit në programet e ciklit të tretë të studimit të doktoratës,
në Universitetin e Tiranës”**

Bazuar në ligjin nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 38 dhe 77; Statutin e UT-së, neni 31, gërma “u”; Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; VKM nr.112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, të ndryshuar; Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; nenin 23, të Rregullores “Për organizimin e programeve të studimit të doktoratës në UT”; Vendimin nr.16, datë 26.04.2021, të SA, dhe Vendimin nr.11, datë 27.04.2021, të BA, në mbledhjen e datës 23.11.2022, Senati Akademik i UT-së,

VENDOSI:

1. Për kandidatët që kanë fituar të drejtën për të ndjekur programe studimi të ciklit të tretë të doktoratës, në njësitë kryesore, të cilët janë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin e Tiranës, tarifa e shkollimit përballohet nga të ardhurat e vetë institucionit.
2. Për kandidatët që vijnë nga jashtë Universitetit të Tiranës, tarifa përballohet nga vetë kandidati ose nga institucioni që mbështet kërkimin shkencor sipas një marrëveshje paraprake midis tyre.
3. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof.Dr. Artan HOXHA

